



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:156707

Datë: 27.02.2025

Numri i dokumentit: 06916533

**C.nr.564/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN / DEGA NË SUHAREKË**, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, dhe me bashkëpunëtorin profesional Labinot Demiraj, në çështjen juridike civile të paditëses A.V nga fshati S, komuna Suharekë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit i autorizuari L. V, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi D. I, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit e pa përcaktuar, pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 11.02.2025 në prani të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 27.02.2025, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.V nga fshati S, komuna Suharekë dhe OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig”, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material për lëndimet e marra nga aksidenti i datës 18.09.2020, t’ia kompenson shumat si vijon:

- a. Për rehabilitim fizioterapeut shumë prej 1,500.00 euro.
- b. Për ndihmën nga personi tjetër shumë prej 300.00 euro.
- c. Në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300.00 euro

Shumën e tërësishme si në pikën (a), (b) dhe (c) prej 2,100.00 euro, me kamatë ligjorë prej 8% ,prej momentit të parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit si e pabazuar përtej shumës të gjykuar sikur në pikë I (një) të dispozitivit të aktgjykimit.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë në lidhje me kërkesën në emër të dëmit jo material për shkak të parashkrimit të kërkesës i cili ka kërkuar që:

*“Të aprovohet kërkesëpadia për demin jo material dhe atë: Për frikë primare dhe sekondare të intensitetit të ndryshëm të konstatuar në raportin mjekësor në shumë prej 3,500.00 euro. Për dhembje fizike të intensiteteve sipas raporteve mjekësore në shumë prej 3,500.00 euro.*

IV. OBLIGOHET e paditura që t'ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës në vlerë prej 994.00 euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën pasojat e përmbarrimit.

#### A r s y e t i m

##### - *Prezantimet e palëve ndërgjyqëse*

Në këtë gjykatë më 12.11.2020, paditësja ka paraqitur padi kundrejt të paditurës, për t'ia kompensuar dëmin, të cilin e ka pësuar më 18.09.2020, rreth orës 17:40, si pasojë e një aksidenti i cili ka rezultuar me lëndime trupore dhe dëme materiale, ku kanë qenë të përfshira gjashtë automjete.

Paditësja si në padi edhe përgjatë seancave gjyqësore, po ashtu edhe në fjalën përfundimtare është deklaruar se: Mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë, pas administrimit të provave nuk është kontestuese se kompania e cila ka qenë e siguruar nga e paditura ka shkaktuar dëm material dhe jo material, sa i përket pretendimit të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës për dëm jo material pas precizimit të kërkesëpadisë ka theksuar se dëmi i shkaktuar nga vetura e cila ka qenë e siguruar nga kompania e të paditurës ka ndodhur me datë 18.09.2020, ndërsa padia është parashtruar pas 2 muajve, ndërsa precizimi objektiv është bërë pas nxjerrjes së provës me ekspertizë nga ekspertet dhe se nuk kemi asnjë parashkrim për shkak të përgjegjësisë së gjykatës e cila ka caktuar seancën në vitin 24/25. Po ashtu ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj padinë si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që paditëses t'ia paguaj shumat si në precizimin e bërë si shpenzimet e procedurës dhe atë si në vijim, 104.00 euro për padi, 135.00 euro për seancën e parë, 135.00 euro për seancën e dytë, dhe shumën prej 600.00 euro për tre ekspertizat e punuara si dhe 20.00 euro për taksë në total shumën prej 994.00 euro.

Pala e paditur si në përgjigje në padi edhe përgjatë seancave gjyqësore, po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave nga ana e gjykatës vlerësojmë se është vërtetuar qëndrimi jonë sa i përket kërkesës në lidhje me dëmin material dhe jo material për lëndimet e pësuar nga aksidenti i datës 18.09.2020 pasi që zgjerimi i padisë në aspektin objektiv në lidhje me lëndimet është bërë në seancë në datën 24.10.2024, pra tani kemi të bëjmë me kërkesë të re të kësaj padie dhe kemi parashkrim të kërkesës. Po ashtu ka shtuar se sa i përket kërkesave në lidhje me dëmin material, ndihmës së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar gjykata ta ketë parasysh se për të njëjtat kategori të dëmit paditësja nuk ka ofruar prova materiale. Kupona fiskal që e vërtetojnë shkaktimin e një dëmi të tillë. Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ta ketë parasysh suksesin e palëve në procedurë nga neni 452 i LPK – së.

##### - *Provat e administruara*

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, përkitazi me propozimin e palëve, gjykata, në seancën kryesore të datës 11.02.2025, ka bërë administrimin e provave dhe atë:

Bëri shikimin në Raportin e aksidentit, policisë nr. 2020 TR 257 i dt. 18.09.2020, Raportin e lëshuar nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i datës 18.09.2020 me numër 55070, Raportin specialistik të Dr. Avni Xhafa i datës 13.10.2020, Raporti specialistik i Dr.

Avni Xhafa i datës 20.10.2020, Raporti fizioterapeutik i datës 09.12.2020, Ekspertizen mjekësore të ekspertit Dr. Rr. Sh të datës 25.10.2024, Ekspertizën mjekësore të ekspertit Dr. Jeton Zogaj të datës 30.10.2024.

Nga shikimi në Raportin e aksidentit të hartuar nga Policia e Kosovës, Njësia për kontrollin e autostradave gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti ka ardhur kur të 6 automjetet ishin duke qarkulluar në rrugën Prishtinë – Pejë në shiritin e majtë të komunikacionit njeri pas tjetrit më të arritur në fshatin Vragoli saktësisht para pompës së derivateve “IP Petrol”, ku si pasojë e këtij aksidenti janë shkaktuar lëndime trupore dhe dëme materiale në të 6 automjetet e përfshira në aksident.

Nga shikimi në Raportin e lëshuar nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i datës 18.09.2020 me numër 55070, gjegjësisht në anamnezë të raportit është theksuar se raporti sillet si pasojë e aksidentit të shkaktuar, ku nga aksidenti paditësja ka dhembje qafe, koke, shpine dhe barku.

Nga shikimi në Raportin specialistik të Dr. A. Xh i datës 13.10.2020, Raporti specialistik i Dr. A. Xh i datës 20.10.2020, Raporti fizioterapeutik i datës 09.12.2020, gjykata ka provuar faktin se paditësja i është nënshtruar kontrolleve mjekësore tek fizioterapeuti ku i njëjti ka theksuar - rekomanduar paditëses që të vazhdoj me ushtrimet e mësuara, të reduktohen pozicionet që përkeqësojnë dhembjen, po ashtu i njëjti ka theksuar se paditësja është trajtuar me 10 seanca të terapisë fizikale, ku këtyre raporteve i është bashkangjitur kuponi fiskal në vlerë prej 150.00 euro.

Nga shikimi në ekspertizën mjekësore të ekspertit Dr. Rr. Sh, e datës 25.10.2024, gjykata ka provuar faktin se paditësja në bazë të të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë në aksidentin e shkaktuar ka marrë lëndime si ndrydhe koke, qafe, gjoksi, ku të gjitha këto lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore, të cilat kanë shkaktuar dhembje fizike. Gjykata po ashtu e ka ftuar ekspertin ortoped në seancën e shqyrtimit kryesor që jep sqarime shtesë në lidhje me ekspertizën e tij i cili ka theksuar se dhimbjet posaçërisht të larta llogariten prej momentit të goditjes pa marr parasysh a janë lëndime të rënda apo lëndime të lehta, llogariten si dhembje me intensitet posaçërisht të rëndë deri në marrjen e terapisë dhe shfaqjen efekteve të terapisë, ku kjo vie pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë pyetet i ekzaminuari në këtë rast paditësja sa kohë ka zgjatur deri tek arritja në institucionin shëndetësor, dhënia e terapisë dhe shfaqja e efekteve të terapisë përafërsisht është e njëjtë si tek lëndime e rënda edhe tek ato të lehta.

Nga shikimi i ekspertizës mjekësore të psikiatrisë të punuar nga eksperti J. Z me datë 30.10.2024 gjykata nuk ka provuar ndonjë fakt relevant dhe nuk do të lëshohet tutje në elaborimin e të njëjtës për faktin se pas prapësimit të paditurës në lidhje me demin jo material, gjykata konstaton se një kërkesë e tillë është parashkruar konform dispozitës nga neni 357 i LMD – së.

Pas administrimit me ndërgjegje dhe kujdes të veçantë të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, gjykata gjeti se:

*Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.*

**- Aplikimi i të drejtës materiale**

Kështu që, mbi bazën e të gjitha provave të lartcekura, gjykata thekson se, është sajuar rrethana për aplikimin e nenit 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parasheh se: “1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”

Me nenin 140 të LMD-së “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia” i automjetit është përgjegjës, pasi që i ka shkaktuar dëm paditësit.

Sipas nenit 357 të LMD – së parashihet se, citojmë “1. Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijëni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin.”

**- Vlerësimet përfundimtare të gjykatës**

Nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse përgjatë seancave gjyqësore provave të administruara dhe dispozitave ligjore gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se me datë 18.09.2020 ka ndodhur një aksident, ku si pasojë e këtij aksidenti pjesëmarrësit të përfshirë në aksident kanë pësuar lëndime trupore dhe dëme materiale.

Si fakt kontestues për të paditurën ka qenë çështja e parashkrimit të kërkesës në lidhje me kompensimin për dëmin jo material për faktin se paditësja një kërkesë të tillë e ka bërë përmes precizimit gjegjësisht zgjerimit të padisë në aspektin objektiv në seancën e datës 24.10.2024, ndërkaq sa i përket dëmit material të refuzohet për shkak se nuk është mbuluar me prova.

Në lidhje me pjesën aprovuese si në pikën një gjykata erdhi në përfundim duka ia falur besimin provave të administruara siç janë ekspertiza e ekspertit Dr. Rr. Sh, e cila provë ndërlidhet edhe me provën tjetër gjegjësisht raportin fizioterapeutik, ku në pjesën e rekomandimeve është theksuar se paditësja është trajtuar në 10 seanca të terapisë fizikale, ndërsa nga kuponi fiskal gjykata ka vërtetuar faktin se një seancë e mbajtur ka kushtuar na vlerë prej 150.00 euro për çka paditëses ia njohu shumën prej 1,500.00 euro sikurse në pikën e parë të aktgjykimit, nën shkronjën a), ndërsa pjesën tjetër gjykata e ka refuzuar për faktin se përkundër se në ekspertizën e ekspertit ortoped Dr. Rr. Sh, është theksuar se rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 15 ditësh për vitin e parë,

Faktin e lartësisë së kompensimit të dëmit paditësi e ka provuar nëpërmjet provave profesionale si me atë të ortopedisë, psikiatrisë, pra nga ekspertiza e ortopedisë gjykata ka vërtetuar faktin e dëmtimeve që ka marr paditësi nga goditja e veturës për çka paraqesin bazë për kompensimin e dëmit material.

Në lidhje me pjesën aprovuese për ndihmën nga personi tjetër gjykata veproi duke marr për bazë ekspertizën mjekësore të ekspertit ortoped Dr. Rr. Sh, ku i njëjti në ekspertizën e tij ka theksuar se ndihma nga personi tjetër ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 15 ditësh, ashtu që gjykata ia ka caktuar shumën prej 20.00 euro për një ditë, si shumë e cila i është përgjigjur nevojave të paditëses duke marr parasysh gjithmonë faktin se e njëjta ka pësuar lëndime të lehta trupore.

Sa i perket kërkesës për ushqimin e përforcuar gjykata po ashtu ia ka falur besimin ekspertizës së ekspertit Dr. Rr. Sh, sipas së cilës i njëjti ka theksuar se ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm në kohëzgjatje prej 20 ditësh në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasur me materie të nevojshme për shkak të kompensimit të gjakut të humbur.

Gjykata gjatë vendosjes për kompensimin e dëmit material: ushqimit të përforcuar në shumë prej 300.00 euro, si dhe për përkujdesjen e personit të huaj në shumë prej 300.00 euro. Nga këto shuma synohet që të arrihet kompensimi i drejtë i palës paditëse, si një dëm i lindur nga dhimbjet fizike të pësuar, si dhe nevojat tjera si ajo e përkujdesjes nga personat e tretë, për shkak të pamundësisë së kujdesit nga vetë pala paditëse. Kurse përtej vendosjes për kompensimin e këtij lloji dëmi, gjykata vendosi që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses, pasi të njëjtat përmbanin shuma tejet të larta të cilat nuk ishin në harmoni me rrethanat aktuale shoqërore dhe me lëndimet e marra nga aksidenti i shkaktuar.

Në lidhje me pjesën e refuzuar sikurse në pikën e tretë të aktgjykimit sa i perket dëmit jo material, gjykata ka vendosur duke marr për bazë pretendimin e palës së paditur ku ka theksuar në lidhje me kërkesat për kompensimin e dëmit material kemi të bëjmë me parashkrim pasi që ka kaluar afati për mbrojtjen e një kërkesë të tillë konform nenit 357 të LMD – së.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e të paditurës dhe thekson se kërkesëpadia e paditëses në lidhje me dëmin jo material ka arritur afatin e parashkrimit për faktin se dëmi është shkaktuar me datë 18.09.2020, ndërsa precizimi – zmadhimi i padisë në aspektin objektiv ku është përfshirë edhe kërkesa për kompensimin e dëmit jo material është bërë në seancën e datës 24.10.2024. Pra sipas interpretimit të nenit 357 të LMD – së, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marr në dijeni për dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin. Pra duke marr parasysh se aksidenti është shkaktuar me datë 18.09.2020, me crast paditësja si pjesëmarrëse në aksident është njoftuar me dëmin, ku si pasojë ka rrjedhur afati subjektiv në lidhje me parashkrimin e kërkesës, e njëjta kërkesëpadinë në lidhje me kompensimin e dëmit jo material e ka bërë në seancën e datës 24.10.2024, pas kalimit të afatit prej 3 viteve, që për gjykatën një kërkesë e tillë është parashkruar.

Gjykata ka marr për bazë edhe pretendimet e paditësit se për fajin e gjykatës i njëjti nuk ka mundur ta paraqesë një kërkesë të tillë për faktin se e njëjta ka caktuar seancën në vitin 2024/2024, mirëpo gjykata konstaton se paditësi ka mundur që precizimin e kërkesëpadisë, gjegjësisht zmadhimin e saj të bëjë edhe jashtë seance, mirëpo paditësi një gjë të tillë nuk e ka bërë, andaj nuk qëndron një pretendim i tillë se të njëjtit i është pamundësuar bërja e një kërkesë të tillë.

Po ashtu gjykata mori për bazë edhe pretendimet e të paditurës në lidhje me atë se pala paditëse nuk ka mundur të i argumentoj disa nga shpenzimet e dëmit material, mirëpo gjykata konstaton se në lidhje me shpenzimet e mjekimit palës paditëse ja ka njohur këtë të drejtë mbi bazën e provave që pala paditëse ia ka dorëzuar gjykatës, gjegjësisht dëftesave të lartcekura, ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar pikërisht për faktin se nuk janë argumentuar më prova konkrete. Sipas nenit 7 të LPK-së, parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”*

Vlen të theksohet se gjykata gjate përcaktimit të lartësisë së shumave, ka marr për bazë Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla si dhe praktiken gjyqësore në rastin e vendosjes për dëmin material dhe jo material e gjitha kjo me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore si dhe ky kompensim të jetë sipas vlerësimit të gjykatës në harmoi me dëmin e pësuar.

Gjykata vendosi që të obligonte palën e paditur edhe në kompensim të kamatës ligjore vjetore në shkallë prej 8 %, bazuar në nenin 382 të LMD-së, ku si për dëmin jo material kamata fillon të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit ndërsa për dëmin material nga data e parashtrimit të padisë duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme për kamatën i dt. 02.12.2020, tek pjesa e tretë e këtij mendimi (periudha e kamatës), pika XIV dhe XV.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës, gjykata që secila palë të i bart shpenzimet e veta duke u bazuar në nenin 453 të Ligjit të procedurës kontestimore dhe atë 104.00 euro për padi, 135.00 euro për seancën e parë, 135.00 euro për seancën e dytë, 600.00 euro për tre ekspertizat e punuara dhe 20.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Nga të lartcekurat e në kuptim të nenit 143 të LPK – së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2020:156707, 27.02.2025**

**G j y q t a r i**

**Selajdin Gallapeni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda afatit ligjor prej 15 ditësh për në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet të kësaj gjykate.